



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:036398

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05729845

P.nr.58/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpunëtoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në lëndën penale ndaj të pandehurit B... Q... nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e mbron avokat Bardhosh Dalipi nga Gjilani, për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose naaloge nga neni 269 paragrafi 1 i KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, PP.II.nr.206/2024, të datës 30.01.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 24.04.2024, publikisht shpalli, ndërsa më datë 15.05.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit: B... Q...., nga babai A..., nëna H..., e lindur S..., i lindur më dt..., në Gjilan, ku edhe jeton, në adresë në rr....., ka të kryer shkollën e mesme, student, i pa martuar, i pa punë, me numër personal 1173898149, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR S E P S E

Më datë 16.01.2024, rreth orës 01.00h, në Gjilan, në rr..., i pandehuri, pa autorizim ka poseduar substancë narkotike – të llojit “.”, në atë mënyrë që pas dhënies së sinjalit të patrollës policore, me drita rotative, të veturës së markës VW Golf VII, me targa 06-189-FQ, që po e drejtonte i pandehuri B... Q... i njëjti nuk u bindet, por vazhdon në drejtim të qytetit dhe më pas një drejtim të Lagjes Dheu i Bardhë dhe tek udhëkryqi humb kontrollin mbi veturën dhe vetë aksidentohet në shkallët e një shtëpie¹, e më pas largohet nga vendi i ngjarjes duke braktisur veturën, mirëpo pas mbërritjes së Njësititi Patrollues dhe kontrollit të veturës gjendet një qese me substancë të dyshuar narkotike për të cilën i pandehuri pohon se ishte e tija, e cila i

¹ Për të pandehurin është hapur procedurë kundërvajtëse për largim nga vendi i ngjarjes pas aksidentit të trafikut, sipas rastit SHQA0003358984V dhe i është konfiskuar patent shoferi,

sekuestrohet dhe pas testit fushor rezulton të jetë substancë narkotike e llojit "Marihuanë" në peshë 0.29gr, që si e tillë është shpallur si substancë e rrezikshme sipas Ligjit mbi barnat dhe substancat psikotrope dhe precursor².

- me çka ka kryer veprën penale: posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së,

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore si dhe neneve, 4,7,17,38,39,40,42,43,44,69,70,71,72, si dhe nenit 364 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të pandehurin Bleror Qerimi:

E g j y k o n

Me dënim **me gjobë në shumë prej 100(njëqind)euro** dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë dhjetë (60)ditësh, **ku dënimi me burgim me pëlqimin e të pandehurit në kuptim të nenit 44 te KPRK-së, I ZËVËNDSOHET në dënim me gjobë në shumë prej treqindë(300)euro**, të cilën shumë duhet ta paguaj ne dy këste te barabarta duke filluar nga dita pasuese e plotëfuqishmërisëse këtij aktgjykimi.

Mirëpo, nëse eventualisht i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së të njëjtit i zëvendësohet me dënim me burgim duke ju llogaritur çdo 20 euro të barabartë me 1 (një) dite burgimi. ose në mënyrë për pjesëtimore me pjesën e dënimit të gjobës së pa paguar, të cilin dënim duhet ta filloj ta mbaj ne afat prej 15 ditëve nga dita pasuese e pranimit të ftesës nga gjykata.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej njëzetë (20) euro si dhe taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej tridhjetë (30) euro, secila e në bazë të nenit 39 paragrafi 3, nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r y e t i m

1. Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, më datë 30.01.2024, ka ngritur aktakuzën e lartcekur, ndaj të pandehurit Bleror Qerimi nga Gjilani, për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose naaloge nga neni 269 paragrafi 1 i KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të datës 24.04.2024, ish-in prezent Prokurorja e Shtetit, i pandehuri . Në të cilën seancë i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit,

² Ligji Nr.02/L-128, Ligji mbi barnat dhe supstancat psikotrope dhe precursor, neni 2 dhe shtojca
Në këtë shtojcë listohen, bimët barnat narkotike dhe substancat psikotrope me rrezikshmëri të lartë që nuk kanë p-ërdorim në mjekësi dhe veterinë, veprimtaria e të cilave është e ndaluar në Kosovë, Ligji Nr.02/L-128, fq.18.

deklarohet se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen kësaj vepre penale. Po ashtu për këtë pranim janë pajtuar edhe prokurori i shtetit dhe mbrojtësi i tij.

2. Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurores të shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit, për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se e pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht në konsultim me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av. se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike gjithnjë duke u konsultuar me mbrojtësin e tij.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj vepre, ekziston fakti se i pandehuri, ka kryer veprën penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose naaloge nga neni 269 paragrafi 1 i KPRK-së në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve dhe të mbrojtësit lidhur me dënimin, e ka shpallur fajtor të akuzuarin, për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose naaloge nga neni 269 paragrafi 1 i KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se i njëjti e ka pranuar edhe vet.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit me burg, ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën, janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese, ky dënim do të jetë një dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit e të pandehurit, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 69 dhe 72 të KPRK-së, Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka zbutur dënimin dhe ndaj të pandehurit ka shqiptuar dënim, se i pandehuri ka bashkëpunuar me prokuroren e shtetit, pranimin e fajësisë e ka bërë në shqyrtim fillestar në konsultim me mbrojtësin e tij sipas autorizimit se i pandehuri është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale, e se i njëjti ka premtuar se nuk do të kryej vepra tjera penale, sjellje korrekte gjatë shqyrtimit dhe fakti që nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër penale të kësaj natyre. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe i pandehuri me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera

penale. Ndërsa, rrethanë rënduese është se i pandehuri me dashje, ka kryer veprën penale, rrethanat e kryerjes së veprës penale meqë i njëjti i ka ikur policisë dhe rrezikshmëria shoqërore e kësaj veprë penale që është në rritje.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Gjykata, ka konstatuar se me dënim me burg, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Gjyqtari i vetëm gjykues në kuptim të nenit 368 të KPP-së pas shpalljes së aktgjykimit ka dhënë një arsytim të shkurtër lidhur me arsyet përmbledhëse për dënimin e shqiptuar dhe qëllimin që ka synim ta arrij tek i akuzuari Bleror Qerimi duke e disiplinuar të njëjtin por edhe qytetarët potencial që në të ardhmen mos të kryejnë vepra penale. Palët janë paralajmëruar për të drejtën në ankesë.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit, gjykata, duke u bazuar nën 452 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin t'a detyrojë për ti paguar shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
Divizioni Penal
P.nr. 58/2024, më 15.05.2024

Bashkëpunëtorë Profesionale

Gjyqtari i vetëm gjykues

Vlora Selmani-Rahimi

Veli Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet në këto gjykate.